

# **UDHËZUES PËR DREJTUESIT DHE MËSUESIT E SHKOLLAVE PROFESIONALE**

**(Në kuadrin e fillimit të vitit shkollor 2022-23)**

Tiranë, Shtator 2022

## UDHËZUES

### në kuadrin e fillimit të vitit shkollor 2022-23

Udhëzimet dhe sqarimet e mëposhtme u shërbejnë drejtuesve dhe mësimdhënësve të lëndëve dhe moduleve profesionale të shkollave profesionale, si dhe Njësive të zhvillimit, për planifikimin e drejtimeve/profileve profesionale në shkollat e tyre, për analizimin e skeletkurrikulave të drejtimeve/profileve profesionale, për hartimin e programeve mësimore të detajuara (teorike dhe praktike) të nivelit shkollor, si dhe për zbatimin e tyre në procesin mësimor (përfshirë mësimdhënien dhe vlerësimin e nxënësve).

#### **1. Në lidhje me Drejtimet/profilet dhe Nivelet e kualifikimeve të Arsimit Profesional në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve**

- Edhe gjatë vitit shkollor 2022-23, Arsimi Profesional (AP) parauniversitar do të vijojë të ofrohet pas arsimit të detyruar 9 vjeçar (Niveli I i KSHK), me një kohëzgjatje maksimale 4 vjeçare, në **tri nivele**, referuar Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK):

- Niveli II i KSHK (me strukturë 2 vjeçare) – punonjës gjysëm i kualifikuar
- Niveli III i KSHK (me strukturë 2+1 vjeçare) – punonjës i kualifikuar
- Niveli IV i KSHK (me strukturë 2+1+1 vjeçare, 2+2 vjeçare, ose bllok 4 vjeçare) – teknik/menaxher si dhe Maturë shtetërore profesionale

- Shkollat profesionale, me miratim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), përgjegjëse për Arsimin Profesional, mund të ofrojnë gjithashtu edhe kualifikime profesionale të Nivelit V të KSHK, pas të mesmes, me kohëzgjatje 1- 2 vjeçare. Zakonisht, ky nivel shkollimi profesional ndiqen nga nxënës (studentë) të rinj dhe të rritur. Në këtë nivel, përmbajtja është me fokus profesionin (nëpërmjet moduleve teoriko – praktike) dhe përgjithësisht, nuk ofrohen lëndë të kulturës së përgjithshme.

- Arsimi Profesional ofrohet për **drejtime profesionale** (të gjera) dhe më pas, secili drejtim profesional, vijon në disa **profilet profesionale** (më të ngushta).

Në **Aneksin 1** tregohet një paraqitje tabelare e drejtimeve, profileve dhe niveleve të Arsimit Profesional (në korespondencë me kualifikimet profesionale të KSHK).

- Në Nivelin II të KSHK (2-vjeçar), AP ofron kualifikime në drejtime të gjera profesionale. Në Nivelin III të KSHK, për çdo drejtim profesional, AP ofron profile profesionale më të ngushta, me kohëzgjatje 1-vjeçare. Ndërsa Niveli IV i KSHK në AP (dhe matura shtetërore profesionale) përmbushet nëpërmjet tre mundësive: (i) ofrimit të drejtimeve profesionale 1-vjeçare, pas nivelit III të KSHK; (ii) ofrimit të profileve profesionale 2-vjeçare, pas nivelit II të KSHK dhe (iii) ofrimit të drejtimeve profesionale bllok, 4-vjeçare, pas nivelit I të KSHK (arsimit të detyruar).

- Nxënësit që përfundojnë me sukses një nivel të caktuar të KSHK në AP, mund të vijnë shkollimin në nivelin më të lartë (në të njëjtin drejtim ose në një nga profilet e këtij drejtimi) ose mund t'i drejtohen tregut për punës për punësim.

- Nxënësit që përfundojnë me sukses një nivel të KSHK në AP në një drejtim/profil të caktuar, **nuk mund** të vijnë në nivele më të larta në një drejtim tjetër ose në profile të drejtimeve të tjera të AP.

#### **2. Në lidhje me kurrikulat e Arsimit Profesional**

- Dokumenti themelor (kombëtar) i një drejtimi/profilin/niveli të kualifikimit profesional, që ofrohet në shkollat profesionale publike, është **Skeletkurrikuli** i këtij kualifikimi profesional. Çdo skeletkurrikul bazohet në standardin e kualifikimit profesional përkatës.

- Të gjitha skeletkurrikulat e ofruara nga AKAFPK, gjenden në faqen e internetit të kësaj Agjencie, në tabelën përkatëse me adresë: <http://www.akafp.gov.al/tabela/>

- Çdo Skeletkurrikul përmban emërtimin e drejtimit/profilin, nivelin përkatës në KSHK

dhe kohëzgjatjen (p.sh., Skeletkurrikuli për profilin “Shërbime motori”, Niveli III i KSHK, i drejtimit “Shërbime mjetesh transporti”, me kohëzgjatje njëvjeçare). Në kapakun e çdo skeletkurrikuli ndodhet kodi përkatës, p.sh. **H5-III-21** i cili tregon pozicionin e kualifikimit në KSHK. Referuar edhe Tabelës së Skeletkurrikulave të AP (Aneksi 1), kodi i mësipërm tregon që:

- Kualifikimi bën pjesë në grupin “**H**” të drejtimeve profesionale (“Bujqësi”).
- Kualifikimi është i renditur i **5**-ti në listën e profileve të grupit “H” (“Kopshtari”).
- Kualifikimi është profil 1-vjeçar në Nivelin **III** të KSHK.
- Hartimi ose përshtatja e fundit e këtij skeletkurrikuli është bërë në vitin **2021**.

- Dokumenti i çdo Skeletkurrikuli përmban edhe listën e kompetencave që fitojnë nxënësit, tabelën e planit mësimor, programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale, përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale, si dhe udhëzime e të dhëna të tjera të rëndësishme për realizimin e shkollimit profesional përkatës.

- Drejtuesit e shkollave profesionale dhe Koordinatorët e kurrikulave në Njësitë e zhvillimit duhet t’i njohin mësimdhënësit jo vetëm me programet e lëndëve profesionale dhe përshkruesit e moduleve profesionale që secili prej tyre do të trajtojë, por edhe me **skeletkurrikulat e plota** përkatëse.

- Plani mësimor i skeletkurrikulave të AP-së përmban edhe listën dhe shpërndarjen në vite të **lëndëve të kulturës së përgjithshme**, por skeletkurrikuli **nuk përmban** programet e detajuara të këtyre lëndëve. Këto programe përgatiten nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) dhe mund të gjenden në faqen e internetit të ASCAP: <https://www.ascap.edu.al/programi-i-arsimit-profesional-struktura-211/>

Skeletkurrikulat e kualifikimeve profesionale që ofrohen në Arsimin Profesional, së bashku me kodet përkatëse, jepet në format tabelar në **Aneksin 1**. Kjo listë ndryshon dhe pasurohet çdo vit shkollor. Në këtë tabelë tregohen edhe skeletkurrikulat **e reja** dhe skeletkurrikulat që janë **rishikuar** për vitin shkollor 2021-22. Drejtuesit e shkollave profesionale duhet ta studiojnë këtë listë për të analizuar mundësitë e hapjes së drejtimeve/profileve të reja në shkollat e tyre, si dhe për të informuar mësimdhënësit për ndryshimet e ofertës së AP. Ndërsa në **Aneksin 2** detajohen ndryshimet e bëra te secila prej skeletkurrikulave të përmirësuara. Këto ndryshime i shërbejnë mësimdhënësve për të përshtatur planet e tyre të mësimdhënies.

- Mësuesit e teorisë dhe të praktikës në shkollat profesionale, nën drejtimin e Koordinatorëve për Kurrikulat dhe **bazuar në Skeletkurrikulat** e kualifikimeve profesionale që ofrojnë, hartojnë “**kurrikulat shkollore**” (planet e mësimdhënies) përkatëse, të cilat miratohen nga Drejtoria e shkollës, pas pëlqimit të dhënë nga Njësia e Zhvillimit përkatëse. Këto plane të mësimdhënies miratohen në fillim të vitit shkollor por, me miratimin e Njësisë së Zhvillimit, edhe mund të ndryshojnë dhe të ri-miratohen gjatë vitit, për t’iu përshtatur më mirë situatave që mund të krijohen dhe ecurisë së proesit mësimor.

- **Kurrikula shkollore** e çdo kualifikimi profesional përbëhet nga:

- a) “Plani mësimor operativ”, i cili hartohet bazuar në tabelën e “planit mësimor” që jepet në skeletkurrikulin e kualifikimit profesional përkatës;
- b) “Planet e mësimdhënies” së lëndëve teorike profesionale, të cilat hartohen nga mësuesit përkatës nën drejtimin e Koordinatorit të Kurrikulave, bazuar në “programet e përgjithshme të lëndëve profesionale” përkatëse (të përfshira në skeletkurrikul);
- c) “Planet e mësimdhënies” së moduleve praktike profesionale të cilat hartohen nga mësuesit e praktikës (instructorët) përkatës nën drejtimin e Koordinatorit të Kurrikulave, bazuar në “përshkruesit e moduleve profesionale” (të përfshira në skeletkurrikul).
- d) “Programet e praktikës profesionale në biznes”, të cilat hartohen nga mësuesit e praktikës profesionale nën drejtimin e Koordinatorit të Kurrikulave dhe në bashkëpunim me përfaqësuesin (instructorin) e biznesit përkatës.

### 3. Në lidhje me përpilimin e “orarit të shkollës” dhe trajtimin e moduleve praktike.

Kur përpilohet orari i shkollës duhet pasur parasysh që:

- Për **lëndët teorike profesionale** veprohet njësoj siç veprohet edhe me lëndët teorike të kulturës së përgjithshme.
- **Modulet praktike profesionale** (që realizohen në mjediset praktike të shkollës) **rekomandohet** të realizohen me 3 orë në javë ose me 6 orë (1 ditë) në javë (zakonisht, kohëzgjatja e moduleve profesionale është e plotpjestueshme me 3 ose me 6 orë).
- Trajtimi i moduleve të një klase mund të bëhet **në vijimësi** (p.sh. mbaron moduli 1, fillon moduli 2, dhe kështu me radhë), por mund të trajtohen dhe dy ose më shumë module **paralelisht** (p.sh. në një javë, 3 orë moduli 1 dhe 3 orë moduli 2, ose një javë moduli 1 me 6 orë, pra një ditë, dhe javën tjetër moduli 2 po me 6 orë).
- Një modul që ka p.sh., 36 orë, mund të trajtohet edhe me 18 orë në periudhën e parë të vitit, dhe me 18 orë në periudhën e dytë, ose, p.sh., 12 orë në tetor dhe 24 orë në dhjetor (p.sh. në Bujqësi, realizimi i disa moduleve ose RM-ve varet nga stina kur kryhen punime/procese të caktuara).
- Për të shfrytëzuar me efektivitet mjediset e praktikave, një klasë e madhe mund të ndahet në dy grupe nxënësish (nëse lejohet nga pikëpamja administrative), të cilat angazhohen në të njëjtën kohë për dy module (ose dy RM) të ndryshme.
- Pavarësisht nga renditja e moduleve në skeletkurrikul, **rradha** e realizimit të moduleve praktike përcaktohet nga vetë shkolla profesionale (nëpërmjet Njësisë së zhvillimit), duke konsideruar faktorë didaktikë dhe administrativë.
- Përzgjedhja e modulit/moduleve **me zgjedhje të detyruar** (nga lista e moduleve të ofruar në skeletkurrikul) bëhet nga vetë shkolla, duke konsideruar: **(i)** kërkesat e tregut rajonal të punës; **(ii)** kërkesat e nxënësve dhe **(iii)** mundësitë e shkollës për ta trajtuar modulën/modulet përkatëse. Klasa të ndryshme mund të përzgjedhin module të ndryshme me zgjedhje, ose një klasë e madhe, mund të ndahet në dy grupe dhe secili grup përzgjedh module të ndryshme me zgjedhje. Një nxënës (klasë ose grup), pasi e ka përzgjedhur dhe ka filluar realizimin e një moduli me zgjedhje, nuk mund ta ndryshojë më atë.
- Pasi shkolla të ketë përcaktuar modulën (modulet) me zgjedhje që do të trajtojë, atëherë ky modul konsiderohet njësoj si edhe modulet e detyruara.
- Megjithëse në “Planin mësimor” që jepet në skeletkurrikul, rubrika e moduleve me zgjedhje ka 1 ose 2 orë në javë, kjo nuk do të thotë që edhe gjatë realizimit të moduleve me zgjedhje ato duhet të trajtohen çdo javë me nga 1 ose 2 orë. Sikurse theksohet më sipër, pasi përcaktohet moduli (modulet) me zgjedhje, ai konsiderohet si modul i detyruar. Çdo modul me zgjedhje, që do të ketë një total prej 36 (34), 54 (51) orësh etj., do të trajtohet njësoj si modulet e detyruara, pra me ndarje 3 ose 6 orëshe javore (sipas orarit të shkollës).
- Modulet e praktikave profesionale mund të realizohen **të shpërndara gjatë vitit** (me 3, 6, 9, 12 ose 15 orë/javë) siç është sqaruar më sipër, por mund të trajtohen edhe **të grupuara** (p.sh., një, dy ose më shumë javë rrjesht). Një shkollë mund të planifikojë edhe praktika të grupuara (në ndërmarrje ose në mjediset e praktikave të shkollës). Në këtë rast duhet të bëhen rregullimet e nevojshme në orarin e lëndëve teorike (të përgjithshme dhe profesionale). E rëndësishme është të **zbatohet vëllimi i plotë i orëve** të paracaktuara për çdo lëndë/modul në planin mësimor të skeletkurrikulit.
- Modulet praktike (ose RM të veçanta të tyre) mund të realizohen në mjediset e praktikave të shkollës ose në biznese/ndërmarrje. Skeletkurrikuli nuk përcakton pjesën e praktikës profesionale si dhe modulet (ose RM-të e tyre) që duhet të realizohen në mjediset praktike të shkollës apo në mjediset e bizneseve/ndërmarrjeve. Është **vetë shkolla** (Njësia e Zhvillimit) që, në bashkëpunim me biznesin, e përcakton pjesën e praktikës profesionale që do të kryhet në biznes, nisur nga mundësitë konkrete dhe marrëveshjet me bizneset në rajonin përkatës.

Pra, **shkolla ka pavarësi të plotë** në renditjen dhe orarin e trajtimit të moduleve

praktike, sigurisht duke konsideruar dhe faktorë të tjerë si: parimet didaktike, kërkesat dhe vartësinë logjike të moduleve (p.sh., ka raste kur moduli 5 nuk mund të realizohet pa u përmbushur moduli 2), numrin e klasave/grupeve, stinën kur do të kryhet praktika, mjediset në shkollë apo në biznes ku do të realizohen modulet. Për të shfrytëzuar me efektivitet mjediset dhe mjetet për praktikat profesionale, mund të realizohen paralelisht module që nuk kërkojnë të njëjtin mjedis praktike (metoda me poste pune, me rotacion).

#### **4. Në lidhje me hartimin dhe zbatimin e “Planeve të mësimdhënies së lëndëve teorike profesionale”:**

- Në çdo skeletkurrikul jepen programe të **përgjithshme** (sintetike) të lëndëve teorike profesionale, ku **detyruese** (pra, që nuk mund të ndryshohen nga shkolla) janë synimet e lëndëve, temat dhe kohëzgjatjet përkatëse. Mësuesit e lëndëve profesionale, duke punuar në grupe, nën drejtimin e Koordinatorit për kurrikulat, duhet të hartojnë **Planet e mësimdhënies (analitike)**, pra të detajojnë çdo temë, në elementet përbërëse (çështjet, orët, objektivat përkatëse, vendin etj.). Për këtë, rekomandohet të përdoret formati i Planit (shkollor) të mësimdhënies së lëndëve teorike profesionale, i shpërndarë nga AKAFPK (shih **Aneksin 3**).

- Në Planin e detajuar (shkollor) të lëndës, nëntemat (çështjet) e çdo teme duhet të kenë një kohëzgjatje jo më të vogël se 1 orë mësimore, por mund të jenë edhe 2 apo 3 orëshe. Kjo gjë lehtëson si planifikimin e mësimin, ashtu edhe plotësimin e regjistrit nga mësuesi.

- Në rastet kur në skeletkurrikul, ndonjë nga temat e një lënde profesionale ka kohëzgjatje 1 orëshe, atëherë nuk ka vend për detajim të mëtejshëm në çështje, por ajo merret e mirëqenë ashtu siç është.

- Në Planin e detajuar (analitik) shkollor, në përputhje me natyrën e lëndës profesionale, brenda kohëzgjatjes së temave të dhëna në programin e përgjithshëm, duhet të parashikohen edhe orë për provimet, përsëritjet, punën me nxënësit e prapambetur, punët e laboratorit, vizitat mësimore etj., sipas rastit.

- Formatin e “Planit të mësimdhënies së lëndës teorike profesionale” që i është ofruar shkollave nga AKAFPK është **rekomandues**, pra ai edhe mund të ndryshohet, duke u bërë më shumë ose më pak i detajuar se ai i ofruari. Sidoqoftë, mirë është që të gjithë mësuesit e së njëjtës shkollë, nën drejtimin e Njësisë së Zhvillimit, të bien dakord dhe të përdorin të njëjtin format të miratuar nga drejtoria.

- Në **situata pandemie**, në zbatim të udhëzimeve specifike, Planet e mësimdhënies duhet të përshtaten për të krijuar hapësirat e nevojshme dhe për të zbatuar metodologjitë e “mësimin në kushtet e shtëpisë”.

#### **5. Në lidhje me hartimin dhe zbatimin e “Planeve të mësimdhënies së moduleve praktike profesionale”:**

- Në çdo skeletkurrikul paraqiten “**përshkruesit e moduleve praktike profesionale**”, ku detyruese janë kohëzgjatja e modulit, Rezultatet Mësimore (RM), instrumentet dhe kriteret e vlerësimit të nxënësve. Mësuesit e praktikave profesionale (duke punuar në grup, nën drejtimin e Koordinatorit të kurrikulave) duhet që për çdo modul të hartojnë “**Planin e mësimdhënies së modulit praktik**”. Për çdo RM, ata duhet të detajojnë elementet përbërëse (kohëzgjatjen e RM-së, instrumentet e vlerësimit, veprimtaritë mësimore si dhe kohëzgjatjet e tyre, vendin ku do të realizohen, kërkesat për realizimin etj., për çdo veprimtari). Për këtë mund të përdoret formati i Planit të mësimdhënies së modulit, rekomanduar nga AKAFPK (shih **Aneksin 4**).

- Në përshkruesin e modulit, RM-të, instrumentet dhe kriteret e vlerësimit të nxënësve janë **detyruese** (pra, nuk mund të ndryshohen nga shkolla). Mësuesi i praktikës (shkolla) **ka pavarësi** për të përcaktuar kohëzgjatjen e çdo RM-je si dhe për të detajuar “veprimtaritë mësimore, kohët, vendin e realizimit dhe kërkesat për realizimin e RM-së përkatëse”.

- **Rekomandohet** që një RM të mos ketë kohëzgjatje më të vogël se 3 orë mësimore, dhe përgjithësisht, kohëzgjatja e tyre të jetë shumëfish i teorëshit (p.sh. 3; 6; 9; 12 orë e kështu me radhë).

- Kur hartohen “veprimtaritë mësimore”, duhet që kohëzgjatja e tyre të mos jetë më e vogël se 1 orë mësimore, por mund të jenë edhe 2 ose 3 orëshe. Kjo gjë lehtëson si planifikimin e mësimin praktik, ashtu edhe plotësimin e regjistrit. Në rast se planifikohen edhe veprimtari mësimore me kohëzgjatje të vogël (psh, 15 ose 20 minutëshe), atëherë mund të bashkohen 2-3 veprimtari të cilat do të kenë kohëzgjatje totale 1 orëshe. Kjo mundëson plotësimin e regjistrave me veprimtaritë mësimore (temat) përkatëse.

- Në “Planin e mësimdhënies së modulit”, në përputhje me natyrën e modulit profesional, brenda kohëzgjatjes së RM-ve, mund të parashikohen **veprimtari mësimore** që i referohen si atyre që kryhen nga mësuesi i praktikës, ashtu edhe atyre që kryhen nga nxënësit (p.sh., rikujtim i aspekteve teorike, përgatitje e vendit të punës, demonstrim i një procesi pune nga instruktori, praktikim i mbikqyrur ose i pavavrur i një procesi pune nga nxënësit, provim praktik i nxënësve, vizitë mësimore, praktikë shitesë për modulet ose RM-të që nuk janë arritur nga nxënësit e prapambetur etj.).

- Rekomandohet që për çdo modul profesional, të parashikohen disa orë në dispozicion të veprimtarive për mbështetjen e **nxënësve të prapambetur** (që nuk arrijnë të marrin notë kaluese, ose që kanë munguar në RM të caktuara).

- Njësitë e Zhvillimit (Koordinatori i marrëdhënive me biznesin), në bashkëpunim me bizneset, përcaktojnë edhe pjesët (veprimtaritë dhe vëllimet) e moduleve praktike që do të realizohen në mjediset e punës së bizneseve përkatëse. Për këto veprimtari në biznes, hartohet edhe “**Programi i praktikës profesionale në biznes**” (sipas formatit të rekomanduar në **Aneksin 5**). Ky program (i përgjithshëm që i referohet një apo më shumë moduleve praktike), do të pasqyrohet më i detajuar edhe në Planet e mësimdhënies së modulit/moduleve përkatëse, që do të shërbejnë si bazë edhe për plotësimin e regjistrit.

- Formatit i “Planit të mësimdhënies së modulit”, që i është ofruar shkollave nga AKAFPK-së është **rekomandues**, pra ai edhe mund të ndryshohet duke u bërë më shumë ose më pak i detajuar se ai i ofruari. Sidoqoftë, mirë është që të gjithë mësuesit e së njëjtës shkollë, nën drejtimin e Njesisë së Zhvillimit, të bien dakord dhe të përdorin të njëjtin format të miratuar nga drejtoria.

**Shënim:** Në dokumente të ndryshme kurrikulare, për standardet e kualifikimeve, për vetvlerësimin dhe akreditimin e shkollave et., përveç termit Rezultat Mësimor (**RM**), përdoret edhe termi Rezultat i të Nxënit (**RN**). Theksojmë që këto dy terma janë të barazvlefshëm, kanë të njëjtin kuptim. Por, referuar terminologjisë së përdorur në dokumentet e KSHK-së, prirja është që termi RM të zëvendësohet gradualisht me termin RN.

## **6. Në lidhje me “vlerësimin e nxënësve”:**

- Nxënësit vlerësohen me “**nota**” si në **lëndët** teorike profesionale, ashtu edhe në **modulet** praktike profesionale.

Në bazë të Udhëzimit nr. 14, datë 27.5.2021 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, vlerësimi i nxënësve:

- Për kulturën profesionale nota vjetore e një nxënësi do të jetë e **rrumbullakosur me numër të plotë**.

- Për lëndët e kulturës së përgjithshme në AP, do të bëhet në përputhje me udhëzimet e MASR-së dhe institucioneve përgjegjëse në varësi të saj.

**I. Vlerësimi i nxënësve për lëndët e teorisë profesionale në nivelin 2–5 të KSHK-së do të jetë:**

1. Për teorinë profesionale, nxënësi gjatë vitit shkollor vlerësohet:
  - a) për një ose disa orë mësimore të sapo zhvilluara (**vlerësim i vazhduar**);
  - b) për një ose disa tema (kapituj), sipas programit lëndor (**vlerësim përmbledhës**).
2. Nota vjetore e një nxënësi për teorinë profesionale, njehsohet me formulën: Nota vjetore lëndore =  **$K1 \times M1 + K2 \times M2$** , ku **M1, M2** janë përkatësisht mesataret aritmetike të vlerësimeve për pikat 1/a dhe 1/b dhe **K1** dhe **K2** janë koeficientët e ponderimit, të cilët përcaktohen në varësi të vëllimit dhe rëndësisë së njësive mësimore.
3. Koeficientët e ponderimit K1 dhe K2 për çdo lëndë, përcaktohen nga Njësia e Zhvillimit dhe dokumentohen në Planet e mësimdhënies së lëndëve teorike profesionale përkatëse (Aneksi 3), të cilat përgatiten në fillim të vitit shkollor dhe miratohen nga drejtori i ofruesit. Pas miratimit, këta koeficientë janë detyruesë të zbatohen nga mësuesi përkatës i lëndës.

**II. Vlerësimi i nxënësve në modulet praktike profesionale në nivelin 2–5 të KSHK-së mund të jetë:**

- a) vlerësim i vazhdueshëm (gjatë kryerjes së veprimtarive praktike);
  - b) dhe/ose vlerësim përmbledhës (në fund të çdo rezultati mësimor (RM)).
1. Në çdo modul praktik profesional, për çdo RM, nxënësi vlerësohet gjatë dhe në fund të periudhës që i përket përmbushjes së një RM-je.
  2. Nota për modulin llogaritet si mesatare e ponderuar e vlerësimeve për çdo RM.
  3. Për praktikën profesionale në ndërmarrje/biznes, nxënësi vlerësohet nga mësimdhënësi i praktikës së shkollës, në bashkëpunim me instruktorin në biznes, në fund të realizimit të kësaj praktike.
  4. Notat e modulit praktik evidentohen në regjistër, ashtu sikurse edhe për lëndët teorike profesionale.
  5. Nëse një nxënës nuk arrin të marrë notë kaluese në një ose disa RM, atij i jepet një shans i dytë për t'u rivlerësuar (pasi të ketë zhvilluar veprimtari praktike shtesë për këtë/këto RM).
  6. Në fund të realizimit të çdo **projekti të nxëni** (vetëm për drejtimin mësimor “Instalues i sistemeve termohidraulike”), nxënësi vlerësohet për anën teorike dhe praktike. Nota për një projekt të nxëni llogaritet si mesatare e thjeshtë e vlerësimeve për anën teorike dhe atë praktike.
  7. Për praktikën profesionale në ndërmarrje/biznes, nxënësi vlerësohet nga mësimdhënësi i shkollës në fund të realizimit të kësaj praktike, në bashkëpunim me instruktorin e biznesit.
  8. Vlerësimi i nxënësve/studentëve në modulet teoriko-praktike (tipike për kualifikimet e nivelit 5 të KSHK, pas të mesmes) bëhet veçmas për pjesët (RM-të) teorike dhe veprimtaritë (RM-të) praktike. Këto pjesë vlerësohen të veçanta, sipas udhëzimeve të mësipërme. Nota e modulit llogaritet si mesatare e ponderuar e notës për teorinë dhe notës për praktikën.
  9. Nxënësi që ka munguar në një prej vlerësimeve të mëposhtme:
    - a) në vlerësimin e një ose disa RM-ve të një moduli;
    - b) në vlerësimin e pjesës teorike ose praktike të një projekti të nxëni, atëherë ai është i detyruar t'i nënshtrohet këtij vlerësimi brenda vitit shkollor.

- Që një modul të konsiderohet i plotësuar nga nxënësi, ai duhet të angazhohet në veprimtaritë e çdo RM-je dhe **të vlerësohet me notë për shkallën e përmbushjes së çdo RM-je**. Këto nota duhet të pasqyrohen në regjistër. Një nxënës duhet të ketë **të paktën një notë për çdo RM**. Nota përfundimtare e modulit praktik pasqyrohet në regjistër, ashtu sikurse edhe për lëndët teorike.



- Nëse një nxënës (për arsye të ndryshme) nuk ka mundur të marrë pjesë në realizimin e një moduli të caktuar, atëherë shkolla (mësimdhënësi përkatës) duhet t'i krijojë mundësi që, në mënyrë të individualizuar, të praktikohet dhe të vlerësohet për këtë modul (në kuadrin e orëve që duhet të planifikohen te çdo modul për praktika shtesë të nxënësve të prapambetur).

- Vlerësimi i kompetencave të nxënësve duhet të bëhet kryesisht nëpërmjet "**listave të kontrollit**", të cilat verifikojnë arritjet e nxënësve kundrejt "**kritereve të vlerësimit**", që janë detyruese. Këto të fundit duhet të merren (kopjohen) nga rubrika përkatëse në çdo RM të modulit dhe mund të pasurohen më tej me specifikime të niveleve të arritjes së nxënësve. Listat e kontrollit mund të jenë individuale (për çdo nxënës) ose kolektive (një listë për të gjithë grupin ose klasën). Në të dyja rastet, kriteret e vlerësimit duhet të jenë të njëjta.

### III. Vlerësimi i nxënësve në provimet përfundimtare të niveleve 2–5 të KSHK-së

1. Nxënësit që ndjekin arsimin profesional, në përfundim të niveleve 2, 3 dhe 5 të KSHK-së, për të gjitha drejtimet/profilet e AP-së, ju nënshtrohen këtyre provimeve përfundimtare të niveleve:

- a) provimit përfundimtar të teorisë profesionale të integruar;
- b) provimit përfundimtar të praktikës profesionale të integruar;

2. Nxënësit që ndjekin arsimin profesional, në përfundim të nivelit të 4-t të KSHK-së, i nënshtrohen vetëm provimit përfundimtar të praktikës profesionale të integruar (pjesa teorike vlerësohet nëpërmjet Provimit të Teorisë profesionale të integruar, si provim i Maturës shtetërore profesionale).

Për sa i takon vlerësimit në provimet përfundimtare të çdo niveli, t'i kushtohet kujdes përdorimit të **Programeve Orientuese** për **Provimet e niveleve**, të publikuara në faqen e internetit të AKAFPK-së në linkun <http://www.akafp.gov.al/tabela-e-struktures-se-programeve-orientuese-te-ap-2020-21/>, të cilat vazhdimisht përshtaten në përputhje me ndryshimet kurrikulare përkatëse.

- Rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet dhe zbatimit të Udhëzimit të MFE Nr. 15, datë 26.04.2019 "**Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në Arsimin dhe Formimin Profesional**".

- Gjithashtu, në linkun e mëposhtëm do të gjeni edhe **Programet orientuese të Maturës shtetërore profesionale** (<http://www.akafp.gov.al/vleresimi-dhe-certifikimi/programe-orientuese-matura-shteterore-profesionale/>). Duke filluar nga Marsi 2023, do të gjeni Programet e reja orientuese për vitin shkollor 2022-23.

- Në faqen e internetit të AKAFPK-së (<http://www.akafp.gov.al/vleresimi-dhe-certifikimi/banka-testesh-per-provimet-e-niveleve/>) ofrohen edhe "**banka testesh**" të cilat përmbajnë njësi testesh teorike për lëndët profesionale. Këto njësi testesh mund të përdoren (pasi të përshtaten) nga mësuesit për testet e vlerësimit të vazhduar ose përmbledhës, si dhe për provimet përfundimtare të teorisë profesionale të niveleve.

### 7. Në lidhje me "plotësimin e regjistrave":

- **Lëndët e teorisë profesionale** plotësohen në regjistër në përputhje me udhëzimet e MAS.

- **Lëndët e teorisë profesionale** plotësohen me temat/çështjet dhe elemente të tjera, në përputhje me rubrikat që përmban regjistri i riformatuar, për këto lëndë.

- **Modulet** e praktikës profesionale, pavarësisht nga kohëzgjatja, **plotësohen në regjistër në mënyrë të ngjashme me lëndët teorike profesionale**. Çdo modul praktik duhet të ketë faqe të veçantë në regjistër dhe të plotësohet për frekuentimin (mungesat),



për notat dhe për veprimtaritë (në vend të temave/çështjeve që shënohen te lëndët teorike, te modulet praktike shënohen “veprimtaritë mësimore”). Këto veprimtari mund të jenë me kohëzgjatje 1, 2 ose 3 orëshe, sikurse janë planifikuar më parë nga mësimdhënësi (te plani i mësimdhënies së modulit) dhe miratuar nga drejtori i shkollës.

- Edhe pjesa e **praktikave profesionale në biznes** (referuar modulit përkatës) plotësohet në regjistër duke renditur veprimtaritë praktike, bazuar te “programi i praktikës profesionale në biznes” të hartuar në bashkëpunim me përfaqësuesit e biznesit.

- Në lidhje me frekuentimin dhe mungesat e nxënësve te modulet, zbatohen të njëjtat rregulla si dhe për lëndët teorike profesionale.

## **8. Në lidhje me ndryshimet e javëve mësimore.**

- Në udhëzimet e ndryshme të lëshuara nga MFE dhe MAS mund të bëhen ndryshime të herëpashërshme të numrit të javëve mësimore në vite të ndryshme të shkollimit në Arsimin Profesional. Këto ndryshime nuk janë të konsiderueshme (luhaten midis 32-36 javë në vit) dhe **nuk mund** të pasqyrohen në skeletkurrikulat e hartuara më parë. Në këto raste, mësuesit specialistë të lëndëve dhe praktikave profesionale, nën drejtimin e Koordinatorit të kurrikulave, duhet të bëjnë vetë llogaritjet e duhura përkatëse, duke konsideruar ndryshimet në javët mësimore (shtim apo pakësim orësh) dhe t'i pasqyrojnë ato edhe në planet e mësimdhënies (të detajuara) të lëndëve dhe moduleve profesionale, të cilat i miratojnë në drejtoritë e shkollave profesionale përkatëse.

## **9. Në lidhje me ndryshimet në lëndët e kulturës së përgjithshme në Arsimin Profesional.**

- Në kuadrin e reformimit të kurrikulës bërthamë të arsimit parauniversitar, në zbatim të urdhërit të përbashkët të MAS dhe MMSR, Nr.69, dt. 14.04.2016, “Për rishikimin e planit mësimor të lëndëve të kulturës së përgjithshme të kualifikimeve profesionale të niveleve I-II-III të Arsimit Profesional”, ish-Instituti i Zhvillimit të Arsimit (aktualisht ASCAP), në bashkëpunim me AKAFP, ka hartuar Planin mësimor dhe programet lëndore (të rishikuara) për të tre strukturat e kualifikimeve të Arsimit Profesional (2+1+1, 2+2 dhe bllok 4 vjeçar), për klasat 10, 11, 12 dhe 13, të cilat do të zbatohen edhe për vitin shkollor 2021-22. Këto programe do të gjenden në faqen e internetit të ASCAP, në adresën: <https://www.ascap.edu.al/programi-i-arsimit-profesional-struktura-211/>

- [Ndërsa Plani mësimor i çdo kualifikimi profesional, ku tregohet edhe lista e lëndëve të kulturës së përgjithshme për çdo klasë, gjendet në skeletkurrikulat përkatëse të publikuara në faqen e internetit të AKAFP.](#)

- Kini parasysh që edhe në përzgjedhjen e teksteve mësimore për lëndët e kulturës së përgjithshme të kl.10, 11, 12 dhe 13, do të përdoret Plani mësimor dhe programet e reja, të rishikuara (në të gjitha rastet, për lëndët e kulturës së përgjithshme, do të përdoren tekstet bazë që janë hartuar dhe miratuar nga MAS për Arsimin e Mesëm të Përgjithshëm).

### Shënim:

Vetëm drejtimi i “Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)” dhe profilet e këtij drejtimi **nuk do ta zhvillojnë lëndën e TIK** si pjesë e Planit mësimor të kulturës së përgjithshme (çështjet e kësaj lënde trajtohen hollësisht në lëndët/modulet e kulturës profesionale përkatëse).

## **10. Udhëzime të tjera:**

- Drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale duhet të kërkojnë periodikisht në **faqen e Internetit** të Agjencisë Kombëtare të AFPK-së ( [www.akafp.gov.al](http://www.akafp.gov.al) ) pasi aty mund të marrin: udhëzime dhe sqarime të ndryshme, skeletkurrikulat, standardet e profesioneve, standardet e kualifikimeve profesionale, materiale mësimore mbështetëse

(për lëndët profesionale), programet orientuese të provimeve teorike dhe praktike, shembuj (banka) pyetjesh për testet teorike profesionale, studime, raporte, informacione dhe botime të ndryshme për AFP-në, njoftime për pjesëmarrje si bashkëpunëtorë në grupet e punës së AKAFPK etj.).

- Të gjitha skeletkurrikulat, programet e lëndëve dhe përshtetjet e moduleve kanë **kode** të veçanta, ku dy numrat e fundit tregojnë vitin e hartimit ose të rishikimit të fundit (p.sh., H-II-20 do të thotë: H – drejtimi Bujqësi; II – Niveli II i KSHK – miratuar në vitin 2020). Meqenëse këto dokumente kurrikulare ndryshojnë dhe përmirësohen vazhdimisht, drejtuesit dhe mësuesit e shkollave profesionale duhet të bëjnë kujdes që të **verifikojnë dy numrat e fundit** të kodit të skeletkurrikulit dhe të përzgjedhin e përdorin versionet më të fundit.

- Drejtuesit dhe stafi i shkollave profesionale, para se të bëjnë përzgjedhjen e drejtimeve/profileve profesionale të reja që do të hapin në shkollat e tyre, duhet të konsultohen me Listën e përditësuar të Skeletkurrikulave të kualifikimeve profesionale (**Aneksi 1**) që ofrohen në Arsimin Profesional në vitin shkollor përkatës, ku edhe evidentohen skeletkurrikulat e reja dhe ato të rishikuara. Shpjegime më të hollësishme për ndryshimet që janë bërë në skeletkurrikulat e rishikuara jepen në **Aneksin 2**.

- Mësuesit e lëndëve teorike dhe moduleve praktike profesionale duhet që të njihen me të gjithë skeletkurrikulin në tërësi, si dhe me rubrikat përkatëse, dhe jo vetëm me lëndën ose modulën që do të trajtojnë. Rekomandohet që ata të studiojnë edhe dokumentet e **standardeve të profesioneve dhe të kualifikimeve profesionale** përkatës (që gjenden në faqen e internetit të AKAFPK (përkatësisht <http://www.akafp.gov.al/lista-kombetare-e-profesioneve/> dhe [AKAFP | Lista Kombetare e Kualifikimeve](http://www.akafp.gov.al/lista-kombetare-e-kualifikimeve/)

- Ka raste kur skeletkurrikulat 2 ose 4 vjeçare rishikohen dhe kanë ndryshime të thella. Në këto raste, skeletkurrikuli i rishikuar futet vetëm në klasën e parë të këtij 2 ose 4 vjeçari, ndërsa klasat e mëpastajme vijojnë me skeletkurrikulin e mëparshëm (kalimtar) derisa të mbyllet cikli i këtij skeletkurrikuli.

- Janë dy lëndë profesionale (“Bazat e Sipërmarrjes” kl.12 dhe kl.13 dhe “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm” kl.13) që janë të përbashkëta për të gjitha drejtimet/profilet e arsimit profesional. Për këto lëndë, në faqen e internetit të AKAFPK, në rubrikën “Programe lëndore” ( <http://www.akafp.gov.al/programe-lendore/> ), jepen edhe programet e detajuara (analitike) në mbështetje të mësuesve që i trajtojnë ato.

- Për të ndihmuar përmirësimin e skeletkurrikulave, lëndëve ose moduleve të veçanta, rekomandohet që drejtuesit, mësuesit dhe Koordinatorët e kurrikulave të identifikojnë problemet më tipike gjatë zbatimit të tyre dhe të përgatisin **propozime të argumentuara** për ndryshime në to. Për këto propozime mund të kontaktojnë specialistët e Sektorit të Hartimit të Kurrikulave dhe Materialeve Mbështetëse në AKAFPK, ose mund t'i dërgojnë në adresën [info.akafp@akafp.gov.al](mailto:info.akafp@akafp.gov.al), çdo vit shkollor, deri në fund të Marsit.

- Gjithashtu, për të ndihmuar në përmirësimin e programeve orientuese për provimet përfundimtare të çdo niveli, rekomandohet që propozimet e argumentuara për ndryshime të dërgohen në adresën [info.akafp@akafp.gov.al](mailto:info.akafp@akafp.gov.al) çdo vit shkollor, deri në fund të Janarit.

- Përveç atyre që përmban skeletkurrikuli përkatës, shkollat profesionale mund të propozojnë edhe **module të tjera me zgjedhje të detyruar** për kualifikimet profesionale që ato ofrojnë. Këto propozime duhet të argumentohen dhe të bazohen te nevojat rajonale për kompetenca të veçanta profesionale (në kuadrin e kualifikimit përkatës), si dhe te mundësitë e shkollës për zbatimin efektiv të këtyre moduleve. Këto propozime të dërgohen në rrugë zyrtare në adresën e AKAFPK [info.akafp@akafp.gov.al](mailto:info.akafp@akafp.gov.al) për Sektorin e Hartimit të Kurrikulave dhe Materialeve Mbështetëse deri më 15 Mars të çdo viti shkollor.

Për të mbështetur mësuesit dhe nxënësit në procesin mësimor, në kushtet e mungesës së teksteve mësimore të mirëfillta, AKAFPK ka përgatitur dhe ofron një numër të madh **“materialesh mësimore mbështetëse”** për lëndët profesionale dhe modulet profesionale kryesore për të gjitha drejtimet/profilet profesionale, veçanësisht për ato që ndiqen nga një numër i madh nxënësish. Këto materiale publikohen në tabelat përkatëse, në linkun <http://www.akafp.gov.al/dokumente-kurrikulare/materiale->

[mesimore/](#), tabela të cilat plotësohen vazhdimisht me materiale të reja.

## **11. Ndryshimet në Skeletkurrikulat e Arsimit Profesional për vitin shkollor 2022-2023**

Nisur nga zhvillimet dhe kërkesat e tregut të punës për kualifikime profesionale, si dhe nga informacionet, komentet dhe kërkesat e marra nga shkollat profesionale në lidhje me nevojat për kualifikime profesionale dhe ecurinë e zbatimit të skeletkurrikulave për kualifikimet që janë në zbatim, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) ka përgatitur kualifikime të reja dhe ka rishikuar kualifikime në zbatim. Bazuar në standardet e këtyre kualifikimeve, janë hartuar dhe rishikuar e përshtatur edhe skeletkurrikulat përkatëse. Të gjitha skeletkurrikulat e miratuara për vitin shkollor 2022-23, përfshirë dhe ato të reja dhe të rishikuara, janë të publikuara dhe mund të shkarkohen në rubrikën “Tabela e strukturës së skeletkurrikulave”, në linkun <http://www.akafp.gov.al/tabela/> të faqes së internetit të AKAFPK.

Në vijim jepet një informacion i detajuar në lidhje me këto risi. Në kuadrin e parapërgatitjeve në shkollat profesionale për fillimin e vitit të ri shkollor 2022-23, ky informacion do të lehtësojë punën e drejtuesve të shkollave për orientimin e shkollave dhe planifikimin e burimeve të nevojshme, si dhe punën e Njësive të Zhvillimit dhe Mësuesve të teorisë dhe të praktikës, për të përgatitur planet e mësimdhënies.

### **a) Ndryshime të përgjithshme në skeletkurrikulat e Arsimit Profesional:**

Programi i Lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, lëndë e cila trajtohet në të gjitha drejtimet/profilet e Arsimit Profesional (përfshirë profilet e drejtimit “Ekonomi biznes”), **është rishikuar** dhe do të zbatohet këtë vit shkollor (programi i kl.13 është rishikuar dhe është zbatuar qysh në vitin shkollor të kaluar). Për të lehtësuar planifikimin e kësaj lënde nga mësuesit përkatës, në rubrikën “Programe lëndore” (<http://www.akafp.gov.al/programe-lendore/>), jepet edhe programi i detajuar (analitik) i kësaj lënde. Materialet mësimore mbështetëse për këtë lëndë në kl.12 dhe kl.13 janë publikuar si drafte në faqen e internetit të AKAFPK te rubrika e materialeve mësimore mbështetëse (draftet finale janë në proces hartimi).

### **b) Skeletkurrikula të reja të Arsimit Profesional**

Për vitin shkollor 2022-23, shkollat profesionale kanë mundësi të ofrojnë për herë të parë edhe 5 kualifikime profesionale të reja, si më poshtë:

1. Profili “Shërbime mekatronike në automjete”, niv. IV i KSHK (2 vjeçar, kl.12 dhe kl.13), në drejtimin “Shërbime mjetesesh transporti”.
2. Profili “Mekatronikë”, niv. IV i KSHK (2 vjeçar, kl.12 dhe kl.13), në drejtimin “Elektroteknikë”.
3. Profili “Instalime hidraulike”, niv. III i KSHK (1 vjeçar, kl.12), në drejtimin “Termohidraulikë”.
4. Profili “Instalime të sistemeve ngrohëse-ftohëse”, niv. III i KSHK (1 vjeçar, kl.12), në drejtimin “Termohidraulikë”.
5. Profili “Ndërmjetësim i pasurive të paluajtëshme”, niv. V i KSHK (2 vjeçar – pas të mesmes), në drejtimin “Ekonomi - biznes”.
6. Profili “Mekatronikë automjetesh”, niv. V i KSHK (1 vjeçar – pas të mesmes), në drejtimin “Shërbime mjetesesh transporti”.

**Shënim:** Kualifikimi i mëparshëm V-III-20-Instalues i sistemeve termohidraulike (me strukturë të bazuar te projektet e të nxënit) , që zbatohet në kl.12 në drejtimin "Termohidraulikë", duke filluar nga viti shkollor 2022-23, **nuk do të zbatohet** në këtë drejtim.

### **c) Skeletkurrikula të rishikuara të Arsimit Profesional**

Për vitin shkollor 2022-23, AKAFPK ka rishikuar dhe përmirësuar 14 skeletkurrikula të Arsimit Profesional që janë në zbatim, si më poshtë:

1. Profili "Shtrim muresh dhe veshje me pllaka", Niv. III i KSHK (1 vjeçar), në drejtimin "Ndërtim".
2. Profili "Punime dekorative dhe bojatisje", Niv. III i KSHK (1 vjeçar), në drejtimin "Ndërtim".
3. Profili "Muratim dhe suvatim", Niv. III i KSHK (1 vjeçar), në drejtimin "Ndërtim".
4. Profili "Miniera", Niv. III i KSHK (1 vjeçar), në drejtimin "Gjeologji – miniera".
5. Drejtimi "Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji", Niv. II i KSHK (2 vjeçar) (**zbatohet vetëm klasa 10**).
6. Drejtimi "Elektroteknikë", Niv. II i KSHK (2 vjeçar) (**zbatohet vetëm klasa 10**).
7. Drejtimi "Hoteleri-Turizëm", Niv. II i KSHK (2 vjeçar) (**zbatohet njëkohësisht klasa 10 dhe klasa 11**).
8. Profili "Guidë turistike", Niv. III i KSHK (1 vjeçar), në drejtimin "Hoteleri-turizëm".
9. Drejtimi "Shërbime sociale dhe shëndetësore", Niv. IV i KSHK (1 vjeçar).
10. Drejtimi "Veterinari", Niv. IV i KSHK (bllok 4 vjeçar) (**zbatohet vetëm klasa 10**).
11. Profili "Shërbime motori", Niv. III i KSHK (1 vjeçar), në drejtimin "Shërbime mjetesesh transporti".
12. Profili "Shërbime xhenerike", Niv. III i KSHK (1 vjeçar), në drejtimin "Shërbime mjetesesh transporti".
13. Profili "Shërbime elektro-auto", Niv. III i KSHK (1 vjeçar), në drejtimin "Shërbime mjetesesh transporti".
14. Drejtimi "Bujqësi", Niv. II i KSHK (2 vjeçar) (**zbatohet vetëm klasa 10**).

Te të gjitha skeletkurrikulat e rishikuara, me kohëzgjatje 2-vjeçare, për vitin shkollor 2022-23 zbatohet vetëm klasa e parë e këtij 2-vjeçari, ndërsa klasa pasardhëse vijon me skeletkurrikulin e mëparshëm (të pa-rishikuar). Përfundimisht bën skeletkurrikuli i drejtimit mësimor "Hoteleri – Turizëm", Niv. II i KSHK, i cili zbatohet njëkohësisht në kl.10 dhe kl.11. Gjithashtu, lënda "Bazat e sipërmarrjes", në kl. 12 do të zbatohet e rishikuar në të gjitha skeletkurrikulat (të rishikuara ose jo).

### **d) Skeletkurrikula të profileve të drejtimit "Hoteleri – Turizëm" në të cilat është integruar moduli i detyruar "Komunikimi në gjuhën angleze në hoteleri-turizëm - 2", në kl.12.**

1. Profili "Bar - restorant", niv. III i KSHK (1 vjeçar)
2. Profili "Recepsion", niv. III i KSHK (1 vjeçar)
3. Profili "Recepsion - pilot", niv. III i KSHK (1 vjeçar)
4. Profili "Shërbime në hotel dhe restorant", niv. III i KSHK (1 vjeçar)
5. Profili "Shërbime të udhëtimit dhe turizmit", niv. IV i KSHK (2 vjeçar)
6. Profili "Guidë turistike", Niv. III i KSHK (1 vjeçar)

Në **Aneksin 2** jepen shpjegime më të hollësishme në lidhje me ndryshimet kryesore të kryera në skeletkurrikulat e rishikuara për vitin shkollor 2022-23.

## ANEKSI 1

### Lista e Skeletkurrikulave të kualifikimeve profesionale që ofrohen në Arsimin Profesional në vitin shkollor 2022-23

**Shënim:**

- Skeletkurrikula të reja që futen për herë të parë në vitin shkollor 2022-23 dhe që tregohen me tekst të hijezuar me ngjyrë të gjelbër.
- Skeletkurrikula të rishikuara për aspektet e kulturës profesionale për vitin shkollor 2022-23 dhe që tregohen me tekst të hijezuar me ngjyrë të kaltër.

Drejtimit mësimore Niveli II i KSHK (2 vjeçare)		Profilet mësimore Niveli III i KSHK (1 vjeçare)		Drejtimit/Profilet mësimore Niveli IV i KSHK (1; 2 dhe 4 vjeçare)
A	A-II-21- TEKNOLOGJI USHQIMORE	1	A1-III-20-Teknologji e përpunimit të brumërave	A-IV-20-TEKNOLOGJI USHQIMORE
		2	A2-III-20-Teknologji e prodhimit të pijeve	
		3	A3-III-20-Teknologji e përpunimit të qumështit	
		4	A4-III-20-Teknologji e përpunimit të mishit dhe peshkut	
		5	A5-III-20-Teknologji e përpunimit të frutave dhe perimeve	
B	B-II-21- NDËRTIM	1	B1-III-22-Muratim dhe suvatim	B-IV-20- NDËRTIM
		2	B2-III-22-Shtrim muresh dhe veshje me pllaka	
		3	B3-III-20-Karpentieri, hekurkthim dhe betonim	
		4	B4-III-20-Punime dhe riparim rrugësh	
		5	B5-III-22-Punime dekorative dhe bojatisje	
		6	B6-III-20-Mirëmbajtje ndërtesash	
C	C-II-21-PËRPUNIM DRURI	1	C1-III-20-Mobileri dhe tapiceri	C-IV-20- PËRPUNIM DRURI
		2	C2-III-20-Prodhome druri gjysmë të gatshme	
D	D-II-20- TEKSTIL KONFEKSIONE	1	D1-III-20-Rrobaqepsi	D-IV-20- TEKSTIL KONFEKSIONE
		2	D2-III-20-Tekstil	
		3	D3-III-20-Modelim	
		4	D4-III-20-Galanteri	
E	E-II-22- ELEKTROTEKNIKË	1	E1-III-20-Instalim elektrik civil dhe industrial	E-IV-21- ELEKTROTEKNIKË
		2	E2-III-20- Instalim dhe mirëmbajtje e linjave të TU dhe TL	
		3	E3-III-20- Riparime të pajisjeve elektroshtëpiake	
		4	E4-III-20-Elektromekanik	
		5	E5-III-20-Teknologji automatizimi	
		6	E6-IV-20-Riparime të pajisjeve elektronike	
		7	E7-IV-20-Telekomunikacion	
		8	E8-IV-22-Mekatronikë	
F	F-II-20- MEKANIKË	1	F1-III-20-Makina metalpunuese	F-IV-20- MEKANIKË
		2	F2-III-20-Konstruksione metalike	
		3	F3-III-20-Mirëmbajtje dhe riparime	

			mekanike	
		4	F4-III-20-Metalurgji dhe fonderi	
		5	F5-III-20-Teknologjia e përpunimit të metaleve	
<b>G</b>	<b>G-II-22- HOTELERI TURIZËM</b>	1	<b>G1-III-22-Bar restorant</b>	<b>G-IV-20- HOTELERI TURIZËM</b>
		2	G2-III-20-Kuzhinë pasqçeri G2/1-III-20-Kuzhinë pasqçeri (pilot)	
		3	<b>G3-III-22-Reception</b> <b>G3/1-III-22-Reception (pilot)</b>	
		4	<b>G4-III-22-Guidë turistike</b>	
		5	<b>G5-III-22-Shërbime në hotel dhe restorant</b>	
		6	<b>G6-IV-22-Shërbime të udhëtimit dhe turizmit</b>	
<b>H</b>	<b>H-II-22- BUJQËSI</b>	1	H1-III-20-Frutikulturë	<b>H-IV-21- BUJQËSI</b>
		2	H2-III-20-Ferma bujqësore e blegtorale	
		3	H3-III-20- Mbarështrim të kafshëve dhe shpendëve	
		4	H4-III-20- Prodhim shtazor	
		5	H5-III-20- Kopshtari	
		6	H6-III-20-Prodhim bimor	
		7	H7-III-20- Akuakulturë	
		8	H8-III-20- Agroturizëm	
		9	H9-III-20- Shërbime kujdesi për kafshë	
		10	<b>H10-IV-20-Teknologji bujqësore</b>	
<b>I</b>	<b>I-II-21- GJELOGJI MINIERA</b>	1	<b>I1-III-22-Miniera</b>	<b>I-IV-20- GJELOGJI MINIERA</b>
		2	I2-III-20-Markshejderi	
		3	I3-III-20-Gjeologji	
<b>J</b>	<b>J-II-21- DETARI</b>	1	J1-III-20-Peshkim	<b>J-IV-20- DETARI</b>
		2	J2-III-20-Teknikë peshkimi	
<b>L</b>	<b>L-II-21-EKONOMI BIZNES</b>	1		
		2	<b>L2-IV-20-Sigurime</b>	
		3	<b>L3-IV-20-Shërbime bankare</b>	
		4	<b>L4-IV-20-Llogari</b>	
		5	<b>L5-IV-20-Sipërmarrje e agjencisë turistike</b>	
		6	<b>L6-IV-20-Tregti</b>	
		7	<b>L7-IV-20-Administrim zyre</b>	
<b>M</b>	<b>M-II-20- SHËRBIME MJETESH TRANSPORTI</b>	1	<b>M1-III-22-Shërbime motori</b>	<b>M-IV-20- SHËRBIME MJETESH TRANSPORTI</b>
		2	<b>M2-III-22-Shërbime xhenerike</b>	
		3	<b>M3-III-22-Shërbime elektroauto</b>	
		4	M4-III-20-Shërbime karrocierie	
		5	M5-III-20-Shërbime në mjetet e rënda të transportit	
		6	M6-III-20-Mekanikë bujqësore	
		7	<b>M7-IV-22-Shërbime mekatronike në automjete</b>	
<b>N</b>	<b>N-IV-22-VETERINARI</b>			
<b>O</b>	<b>O-II-20- SHËRBIME SOCIALE DHE SHËNDETËSORE</b>	1	O1-III-21-Shërbime kujdesi për të moshuar	<b>O-IV-22- SHËRBIME SOCIALE DHE SHËNDETËSORE</b>
		2	O2-III-20- Shërbime kujdesi për fëmijë	
		3	O3-III-20-Animacion social	
<b>P</b>	<b>P-II-20-POLIGRAFI</b>			
<b>Q</b>	<b>Q-II-20- TEKNOLOGJI KIMIKE</b>	1	Q1-III-20-Teknologji e përpunimit të naftës	<b>Q-IV-20- TEKNOLOGJI KIMIKE</b>
		2	Q2-III-20-Teknologji e prodhimit të materialeve të ndërtimit	
		3	Q3-III-20- Teknologji e përpunimit të	



			plastikës dhe gomës	
<b>R</b>	<b>R-IV-20-GJEODEZI</b>			
<b>S</b>	<b>S-II-20-PYJE</b>	1	S1-IV-20-Silvikulturë	
		2	S2-IV-20-Shfrytëzim pyjesh	
		3	S3-IV-20-Florikulturë	
		4	S4-IV-20-Mbrojtje e mjedisit pyjor	
<b>T</b>	<b>T-II-20-TEKNOLOGJI INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI</b>	1	T1-IV-21-Rrjete të dhënash	
		2	T2-IV-21-Mbështetje e përdoruesve të TIK	
		3	T3-IV-21-Zhvillim <i>website</i>	
	<b>T/1-II-20-TEKNOLOGJI INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI-pilot</b>	4	T4-IV-20-Rrjete të dhënash (pilot)	
		5	T5-IV-21-Programim	
		6	T6-IV-21-Multimedia	
<b>U</b>	<b>U-IV-20-SHËRBIME KUJDESI PËR TË MOSHUAR (PILOT)</b>			
<b>V</b>	<b>V-II-20-TERMOHIDRAULIKË</b>	1	<b>V1-III-22- Instalime hidraulike</b>	<b>V-IV-20-PANELE DIELLORE DHE HIDRAULIKE</b>
		2	<b>V2-III-22-Instalime të sistemeve ngrohëse-ftohëse</b>	
<b>X</b>	<b>X-II-22-KËRKIM, SHPIM DHE SHFRYTËZIM NAFTE, GAZI DHE UJI</b>	1	X1-III-20-Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit	<b>X-IV-20-KËRKIM, SHPIM DHE SHFRYTËZIM NAFTE, GAZI DHE UJI</b>
		2	X2-III-20-Shpimi i puseve të naftës, gazit dhe ujit	
<b>Y</b>				
<b>AA</b>				

<b>Kualifikime pas të mesmes Niveli V i KSHK</b>	
<b>NR</b>	<b>PROFILI MESIMOR</b>
<b>1</b>	<b>Diagnostikim-menaxhim në autoservis</b>
<b>2</b>	<b>Laborant ushqimor</b>
<b>3</b>	<b>Dizenjim mode</b>
<b>4</b>	<b>Instruktor në AFP</b>
<b>5</b>	<b>Kontroll laboratorik i ushqimit</b>
<b>6</b>	<b>Shërbime detare në kuvertë</b>
<b>7</b>	<b>Ndërmjetësim i pasurive të paluajtëshme</b>
<b>8</b>	<b>Mekatronikë automjetesh</b>



## **ANEKSI 2**

### **Shpjegime për ndryshimet në Skeletkurrikulat e rishikuara, për vitin shkollor 2022-23**

#### **1. Te skeletkurrikuli i profilit “Shtrim muresh dhe veshje me pllaka”, Niv. III i KSHK (1 vjeçar), në drejtimin “Ndërtim”.**

##### Te kompetencat profesionale:

- Janë plotësuar kompetencat profesionale me aftësi që kanë të bëjnë me riparime dhe kontroll të cilësisë së punimeve, kryerjen e llogaritjeve të volumeve dhe materialeve që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse, planifikimin e nevojës për burimeve njerëzore, shtrimin e sipërfaqeve me materiale plastike, shtrimi të sipërfaqeve me rezinë epoxidike etj.

##### Te lëndët profesionale:

- Lëndët: “Vizatimet e ndërtimit”, “Teknologji shtrimi dyshemesh dhe veshje muresh” dhe “Teknologji shtrimi rrugësh dhe trotuarësh”, kanë ndryshuar synimet dhe përmbajtjen e lëndës, kanë ndryshuar edhe shpërndarjen e orëve mësimore.

##### Te Modulet profesionale të detyruara:

- Moduli: “Punime nënshtresash, nivelimi dhe izolimi të sipërfaqeve” ka ndryshuar titullin, është modul i ri, i bashkuar (ka qënë moduli “Punimi i nënshtresave dhe nivelimit të dyshemeve” dhe është bashkuar me modulin “Punime shtrimi dyshemesh me copa në mjedise të brendshme dhe të jashtme”). Ka pësuar ndryshime përmbajtësore të RM-ve dhe është zvogluar numri i tyre (nga 6 RM, në 5 RM).
- Moduli: “Shtrimi dhe veshja e sipërfaqeve me pllaka” është modul, i cili, vjen nga bashkimi i dy moduleve ekzistues (“Veshja me pllaka e mureve të mjediseve të brendshme” dhe moduli “Punime veshjesh me pllaka të mureve të fasadave”) ka pësuar ndryshime përmbajtësore të RM-ve ekzistuese dhe janë krijuar RM të reja.
- Moduli: “Shtrimi dhe veshja e sipërfaqeve me pllaka dekorative” është modul i ri
- Moduli: “Shtrimi i sipërfaqeve me materiale plastike” është modul i ri.

##### Te modulet profesionale me zgjedhje:

- Moduli: “Shtrimi i dyshemeve me asfaltobeton” ka ndryshuar përmbajtjen e RM-ve dhe numrin e tyre e tyre (nga 4 RM janë bërë 3 RM)
- Moduli “Shtrimi i dyshemeve teknike” është hartuar si modul i ri me 51orë.
- Moduli: “Shtrimi i dyshemesë dhe veshja e fasadave me pllaka mermeri” ka ndryshuar titullin e modulit (ka qënë “Veshja e fasadave me pllaka mermeri”), është shtuar shtrimi i dyshemesë si proces, ka ndryshuar përmbajtjen e RM-ve.
- Moduli: “Shtrimi i sipërfaqeve me rezinë epoksidike” modul i ri.
- Modulet: “ Shtrimi i dyshemeve monolite prej betoni të armuar” dhe “Veshja e mureve të mjediseve të brendshme me letër dekorative” janë hequr.

#### **2. Te skeletkurrikuli i profilit “Punime dekorative dhe bojatisje”, Niv. III i KSHK (1 vjeçar), në drejtimin “Ndërtim”.**

##### Te kompetencat profesionale:

- Janë plotësuar kompetencat profesionale me aftësi që kanë të bëjnë me kryerjen e punime të veshjes me letër murale dekorative me vetëngjitje (adeziv), 3D dhe të personalizuar, ryerjen e punime të bojatisjes me materiale

e teknika bojatisje të ndryshme, në sipërfaqe prej tulle e guri, të brendshme e të jashtme, ryerjen e detyrave administrative e tregtare për punime dekorative dhe të bojatisjes.

#### Te lëndët profesionale:

- Lëndët: “Vizatimet e ndërtimit dhe elementeve dekorative”, “Teknikë e punimeve dekorative”, “Teknikë e punimeve të patinimit dhe bojatisjes” dhe “Teknikë e konstruksioneve mbajtëse”, kanë ndryshuar synimet e e lëndës, temat mësimore, si edhe shpërndarjen e orëve mësimore.

#### Te Modulet profesionale të detyruara:

- Moduli: “Punime dekorative me kartonxhes” ka ndryshuar titullin e modulit, ka pësuar ndryshime përmbajtëse, ka ulur numrin e orëve (nga 120 orë në 102 orë) dhe pakësuar numrin e RM-ve (nga 4 në 3 RM).
- Moduli: “Punimi i elementeve dekorative” ka ndryshuar titullin e modulit, përmbajtjen e RM-ve dhe numrin e tyre (nga 4 në 3 RM).
- Moduli: “Patinime në sipërfaqe të ndryshme” ka ndryshuar titullin e modulit (ka qënë “Punimi i patinimit në sipërfaqe të suvatuara, në mjedise të brendshme të jashtme”) dhe përmbajtjen e RM-ve. Ka ndryshuar numrin e orëve (nga 66, në 84 orë).
- Moduli: “Bojatisje në sipërfaqe të ndryshme” ka ndryshuar titullin e modulit, (ka qënë “Punimi i veshjes me letër murale dhe bojatisjes në sipërfaqe të brendshme e të jashtme, druri e metali”, i cili është ndarë në dy module të veçanta, njëri për bojatisjen dhe tjetri për veshje me letër murale), ka ndryshuar përmbajtjen e RM-ve për bojatisjen.
- Moduli “Veshja e sipërfaqeve me letër murale” ka ndryshuar përmbajtjen e RM-ve ekzistuese dhe janë hartuar RM të reja për punime veshjesh të sipërfaqeve me letër murale dekorative me vetëngjitje, 3D dhe të personalizuar.

#### Te modulet profesionale me zgjedhje:

- Moduli “Punime dekorative të sipërfaqeve me taserina” ka ndryshuar përmbajtjen e RM-ve (RM-të nga 4 janë bërë 3).
- Moduli “Bojatisje në sipërfaqe të brendshme e të jashtme prej tulle e guri” është modul i ri.
- Moduli “Punimi dekorativ i dyshemesë me mozaikë” është hequr fare si modul.

### **3. Te skeletkurrikuli i profilit “Muratim dhe suvatim”, Niv. III i KSHK (1 vjeçar), në drejtimin “Ndërtim”.**

#### Te kompetencat profesionale:

- Janë rishikuar, përpunuar dhe plotësuar kompetencat profesionale në përputhje me përshkrimin e kualifikimit të rishikuar.

#### Te lëndët profesionale:

- Lënda “Vizatimet e ndërtimit”, ka ndryshuar shpërndarjen e orëve mësimore.
- Lënda “Teknologji muratimi dhe suvatimi” ka ndryshuar synimet, përmbajtjen dhe shpërndarjen e orëve mësimore.
- Lënda “Teknologjia e ndërtimit të mureve mbajtëse, pritëse dhe rrjetit ujësjellës-kanalizim në rrugë e trotuare” ka ndryshime në titull, synime dhe në përmbajtje të temave mësimore, si dhe në shpërndarjen e orëve mësimore.

#### Te modulet e detyruara të praktikës profesionale:

- Moduli “Ndërtimi i mureve me tulla të ndryshme” ka ndryshime në titullin e modulit, përmbajtjen e RM-ve, numrin e tyre (nga 8 RM janë bërë 6 RM) dhe sasinë e orëve (nga 84, në 102 orë).
- Moduli “Termoizolimi i mureve” është modul i ri me 66 orë mësimore.
- Moduli “Ndërtimi i mureve me gurë dhe buto-beton” ka ndryshuar titullin, numrin e orëve mësimore (nga 69, në 84 orë) përmbajtjen dhe numrin e RM-ve (nga 5 në 4).

- Moduli “Suvatime të brendshme e të jashtme”, është modul i ri, nga bashkimi i dy moduleve ekzistuese (“Suvatimi i brendshëm” dhe “Suvatimi i jashtëm”) dhe orët mësimore nga 69, janë rritur në 102 orë.
- Moduli “Ndërtimi i mureve me gurë në të thatë” ka ndryshuar titullin (ka qënë “Punimi i mureve mbajtëse në rrugë me gurë”), ka ndryshuar përmbajtjen e RM-ve, numrin e orëve mësimore (nga 51, në 54) dhe numri i RM-ve është pakësuar nga 4, në 3 RM.
- Modulet “Punimi i detajeve të ndryshme në lidhjet e mureve me tulla” dhe “Punimi i patinimit dhe bojatisjes me teknika të ndryshme”, janë hequr.

Te modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar:

- Moduli “Ndërtimi i mureve dekorative” ka ndryshuar titullin (ka qënë moduli “Punimi i mureve dhe tavaneve të varura me gips”), ka ndryshuar përmbajtjen dhe numrin e RM-ve.
- Modulet “Ndërtimi i mureve mbajtëse në rrugë” dhe “Ndërtimi i qemerëve me tulla” kanë ndryshuar titullin, përmbajtjen e RM-ve dhe numrin e RM-ve.
- Moduli “Suvatime dekorative” është i ri.
- Moduli “Punimi i mureve prej betoni të armuar” është hequr.

**4. Te skeletkurrikuli i profilit “Miniera”, Niv. III i KSHK (1 vjeçar), në drejtimin “Gjeologji – miniera”.**

Te kompetencat profesionale:

- Janë rishikuar, përpunuar dhe plotësuar kompetencat profesionale në përputhje me përshkrimin e kualifikimit të rishikuar.

Te lëndët profesionale:

- Lënda “Art Minerar”, Kl.12 ka pësuar ndryshime të theksuara të synimeve dhe të përmbajtjes. Temat 8 dhe 12 kanë ndryshuar dhe kohëzgjatjen.
- Lëndëa “Matje në Minierë”, Kl.12 i janë plotësuar dhe rishikuar synimet dhe përmbajtja.
- Lëndës “Makina dhe pajisje në minierë”, Kl.12, i janë plotësuar dhe rishikuar synimet dhe përmbajtja.

Te modulet profesionale

- Te moduli “Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik në minierë” janë rishikuar dhe përmirësuar RM1 dhe RM3;
- Te moduli “Ndërtimi i planimetrisë së punës së një nënkati shfrytëzimi” janë rishikuar dhe përmirësuar RM1 dhe RM2, si dhe rubrika “Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit”.
- Te moduli “Përdorimi i pajisjeve dhe makinerive në nëntokë dhe karierë” është rishikuar dhe përmirësuar RM2.

**5. Te skeletkurrikuli i drejtimit “Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji”, Niv. II i KSHK (2 vjeçar) (zbatohet vetëm klasa 10).**

Te kompetencat profesionale:

- Janë plotësuar kompetencat profesionale me aftësi që kanë të bëjnë me kryejn e veprimeve praktike në punimet e shpimit të puseve dhe nxjerrjes së naftës, gazit e ujit, përgatjen e materialeve për dokumentimin gjeologjik, marrjen e provave për analiza laboratorike, etiketimin, ambalazhimin dhe dërgimin e tyre në laboratorët përkatës, sipas metodikave dhe instruksioneve të miratuara.

Te lëndët profesionale:

- Lënda “Gjeologji e përgjithëshme” ka ndryshime në shpërndarjen e orëve

- Lënda “Shpimi i puseve të naftës, gazit dhe ujit” si edhe lënda “Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit” kanë pësuar riformulim të temave mësimore dhe rishpërndarje të ngarkesës mësimore sipas temave.
- Lënda “Teknika e sigurimit dhe matjet në shpim dhe nxjerrje” ka pësuar ndryshime të temave bazuar ne legjislacionin në fuqi për masat mbrojtëse.

#### Te modulet profesionale:

- Moduli “Matja e parametrave te thjeshte teknike ne shpim dhe nxjerrje” me 36 ore mesimore eshte shtuar si moduli i pare per klasen e 10.
- Modulet “Identifikimi i dukurive dhe i proceseve gjeologjike në terren“ me 36 orë mësimore, “Operacionet e punës në shpimin e puseve – 1” me 54 orë mësimore, “Operacionet e punës në nxjerrjen e naftës – 1” me 54 orë mësimore, “Operacionet e punës në nxjerrjen e naftës – 2” me 134 orë mësimore dhe “Grumbullimi dhe trajtimi i naftës dhe i gazit” me 68 orë mësimore kanë pësuar disa ndryshime e përmirësime të lehta përmbajtësore.
- Moduli “Teknika e sigurimit në shpim dhe nxjerrje” me 72 ore mesimore ka pesuar dryshime permbajtesore ne harmoni me legjislacionin ne fuqi.
- Moduli “Operacionet e punës në shpimin e puseve – 2” eshte pakësuar me 134 orë mësimore ka pësuar disa përmirësime të lehta përmbajtësore.
- Moduli me zgjedhje te detyruar “Ndërtimi i katalogut të dukurive gjeologjike” me 36 ore mesimore *eshte zevendesuar* me Modulin “Identifikimi i ndotjes në shpim dhe nxjerrje” me 36 orë mësimore dhe jane bere disa permiresime te lehta permbajtesore

### **6. Te skeletkurrikuli i drejtimit “Elektroteknikë”, Niv. II i KSHK (2 vjeçar) (zbatohet vetëm klasa 10).**

#### Te kompetencat profesionale:

- Janë rishikuar, përpunuar dhe plotësuar kompetencat profesionale në përputhje me përshkrimin e kualifikimit të rishikuar.

#### Te lëndët profesionale:

Në klasën 10:

- Te lëndët “Vizatim teknik” dhe “Teknologji elektrike” kanë ndryshuar numri i temave dhe kohëzgjatjet e tyre.
- Te lënda “Bazat e elektroteknikes” kanë ndryshuar synimet e lëndës, numri i temave dhe kohëzgjatjet e tyre.

Në klasën 11:

- Lënda “Elektroteknike, matje elektrike dhe elektronike” është lëndë e re me 68 orë, e krijuar nga bashkimi i disa temave te Elektroteknikes se klases 10 dhe Matjeve elektrike te klases se 11.
- Te lënda “Makinat elektrike” ka ndryshuar numri i temave dhe kohëzgjatjet e tyre.
- Te lënda “Elektronike”, është shkurtuar kohëzgjatja, nga 136 orë, në 102 orë. Disa tema jane grupuar por nuk ka ndryshim ne permbajtje dhe synime.
- Lënda “Sigurimi teknik ne pune” eshte lende e re me 34 ore ne klasen 11.

#### Te modulet e praktikës profesionale

Në klasën 10:

- Te moduli “Punime axhusterie” eshte shtuar nje rezultat mesimor (RM5 “Nxenesi kryen ngjitje me kallaj të elementeve elektrike dhe elektronike në skema të ndryshme”.
- Modulin M-11-1434-20 i eshte ndryshuar titulli në “Punime pergatitore brenda dhe jashte muri per instalime elektrike ne ndertesa”. Eshte shtuar RM1:

Nxënësi vizaton simbolet e elementeve elektrike. RM 2 bashkohet me RM 3 dhe bëhet “Nxënësi hap kanale, vrima dhe fole”.

- Te moduli 11-078-20 “Instalimi i elementeve te skemes elektrike” është pakësuar numri i oreve nga 72 ore ne 36 ore.
- Moduli M-12-1436-20 “Instalimi i rrjetit te internetit dhe telefonise ne ndertesa brenda dhe jashte muri”, nga klasa 11 ka kaluar ne klasen 10. RM 2 bashkohet me RM 3 dhe behet: “Nxënësi hap kanale, vrima dhe fole per instalimin e internetit dhe telefonise brenda dhe jashte muri”. RM 5 bashkohet me RM 6 dhe behet: “Nxënësi vendos tubat, kanalinat dhe kutite per instalimin e internetit dhe telefonise brenda dhe jashte muri” si dhe ndryshon numri i oreve nga 33 ore ne 36 ore.
- Moduli “Realizimi i skemes elektronike te drejtuesit te rrymes”, 36 ore është modul i ri.

Në klasën 11:

- Moduli “Realizimi i skemave te ndryshme te nje instalimi elektrik”, eshte modul i ri me 36 ore.
- Moduli “Riparimi i disa pajisjeve elektroshtepiake” është modul i ri, me 36 orë, nga bashkimi i modulit “Riparimi i motorit asinkron njefazor te pajisjeve elektroshtepiake”, klasa 11 dhe modulit “Riparimi i disa pajisjeve ngrohese elektroshtepiake”, klasa 10.
- Moduli “Shtrirja e kabllit te TU ne toke” është ristrukturuar.
- Moduli “Komandimi i motoreve elektrike nje dhe trefazore“ eshte i ri, me 33 ore.
- Moduli “Riparimi ushqyesve te thjeshte” eshte ristrukturuar:
- Moduli “Tokezimi mbrojtës ne ndertesa” ka disa ndryshime ne përmbajtje.
- Moduli me zgjedhje “Realizimi i skemave elektronike me qarqe të programueshem”, është modul i ri.

## **7. Te skeletkurrikuli i drejtimit “Hoteleri-Turizëm”, Niv. II i KSHK (2 vjeçar) (zbatohet njëkohësisht klasa 10 dhe klasa 11) .**

Te kompetencat profesionale:

- Janë shtuar kompetencat profesionale që kanë të bëjnë me komunikimin në gjuhën angleze në hoteleri - turizëm” dhe me aspektet e dixhitalizimit.
- Janë përmirësuar kompetencat profesionale me aftësi që kanë të bëjnë me ndryshimet në standardin e kualifikimit përkatës.

Te lëndët profesionale:

- Në lëndën “Organizimi i strukturave hoteliere dhe gastronomike” janë bërë ndryshime orësh ndërmjet temave.
- Në lëndën “Ushqim dhe pije” jane bërë janë bërë ndryshime të kohëzgjatjeve të temave, për klasën e 10 dhe të 11.
- Në lëndën “Turizmi dhe mjedisi” janë përmirësuar synimet e lëndës, si dhe është hequr tema “Ndotja e mjedisit dhe trajtimi i mbetjeve”. Është shtuar temë e re: “Turizmi i qëndrueshëm”.
- Në lëndën “Trashëgimia kulturore dhe historike” janë përmirësuar synimet e lëndës dhe temat mësimore. Ka ndryshime edhe në kohëzgjatjet e temave.

Te modulet profesionale:

- Te moduli “Kuzhinë” janë bërë ndryshime në përmbajtjen e të gjitha RM-ve.
- Te moduli “Shërbime në restorant” janë bërë ndryshime të lehta në brendi.
- Te modulet “Shërbime në reception - 1” dhe “Shërbime pastrimi – 1” janë bërë ndryshime në përmbajtje.
- Te modulet 4, 6, 7, 8 janë bërë ndryshime të lehta në përmbajtje.
- Është shtuar moduli i ri “Komunikimi në gjuhën angleze në hoteleri-turizëm”
- Te modulet “Përgatitja menusë me asortimente të zonës, me bazë mishi”, “Përgatitja e menusë me asortimente të zonës, me bazë peshku” dhe “Përgatitja e sallës së restorantit dhe shërbimi për festa” janë bërë ndryshime të lehta në përmbajtje.

## **8. Te skeletkurrikuli i profilit “Guidë turistike”, Niv. III i KSHK (1 vjeçar), në drejtimin “Hoteleri-turizëm”.**

### Te kompetencat profesionale:

- Janë përmirësuar kompetencat profesionale me aftësi që kanë të bëjnë me ndryshimet në lëndën “Guide turistike ” duke u bazuar dhe në Kuadrin ligjor dhe VKM-të e ndryshme të dalta për liçensimin e Udhërrëfyesit turistik.
- Janë përmirësuar kompetencat profesionale me aftësi që kanë të bëjnë me ndryshimet në standardin e kualifikimit përkatës.
- Është shtuar kompetencë e re profesionale që lidhet me modulën e ri “Përdorimi i burimeve të informacionit nga guida turistike”

### Te lëndët profesionale:

- Janë shtuar gjashtë synime për lëndën “Guidë turistike”
- Në lëndën “Guidë turistike” janë bërë ndryshime të orëve dhe janë vendosur tema të reja të domosdoshme për përgatitjen e guidave turistike si më poshtë:  
Tema 4. Arkeologjia shqiptare dhe shtet kryesore arkeologjike në Shqipëri  
Tema 8. Njohuri mbi teknikat e udhërrëfimit, kujdesi dhe siguria për turistin  
Tema 12. Kontributi i udhërrëfyesit turistik në mbështetje të turizmit të qëndrueshëm.  
Tema 13. Një vështrim i përgjithshëm i llojeve kryesore të turizmit në Shqipëri  
Tema 15. Terminologjia në industrinë e turizmit
- Gjithashtu janë hequr tema që nxënësit e këtij niveli i kanë realizuar në nivelin II të KSHK, por që trajtohen edhe në tema të tjera.

### Te modulet profesionale:

- Është shtuar modul i ri “Përdorimi i burimeve të informacionit nga guida turistike”
- Modulet “Pritja dhe përcjellja e grupit turistik”, “Guida gjatë tureve në këmbë” dhe “Guida gjatë tureve me mjete transporti” kanë ndryshime të kohëzgjatjes.
- Moduli “Teknikat e komunikimit” ka ndryshuar titullin dhe trajtohet si modul i detyrueshëm
- Moduli “Guida gjatë tureve në mjedise të mbyllura” trajtohet si modul me zgjedhje

## **9. Te skeletkurrikuli i drejtimit “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, Niv. IV i KSHK (1 vjeçar).**

### Te kompetencat profesionale:

- Janë përmirësuar kompetencat profesionale me aftësi që kanë të bëjnë me ndryshimet në lëndët “Ekonomi shëndeti”, “Kuadri ligjor në shërbimin social-shëndetësor” dhe “Shërbime shëndetësore dhe sociale”.
- Janë përmirësuar kompetencat profesionale me aftësi që kanë të bëjnë me ndryshimet e realizuara në module.
- Është shtuar një kompetencë e re profesionale që lidhet me modulën e ri “Shërbime sociale, argëtuese dhe edukative”.

### Te lëndët profesionale:

- Në lëndën “Ekonomi shëndeti” është bërë ndryshim orësh (nga 96 orë në 64 orë) dhe është hequr tema mësimore nr. 10.
- Është shtuar një lëndë e re: “Shërbime shëndetësore dhe sociale”, me 32 orë.
- Në lëndën “ Kuadri ligjor në shërbimin social-shëndetësor” janë bërë zëvendësime temash mësimore.
- Në lëndën “Teknologjia e informacionit dhe komunikimit në shërbimin social-shëndetësor” është shtuar një temë mësimore.

### Te modulet profesionale:

- Te moduli “Hapja dhe mbyllja e një biznesi në shërbimin social-shëndetësor” janë bërë ndryshime në RM1, RM2, RM3, RM4.

- Te moduli “Menaxhimi i përkujdesjes social- shëndetësore në një qendër të shërbimit social- shëndetësor” ka ndryshuar titulli i modulit dhe ka ndryshime te RM1, RM2, RM3, RM6, si dhe janë hequr RM4 dhe RM5.
- Te moduli “Mirëmbajtja e qendrës së shërbimit social - shëndetësor dhe administrimi i dokumentacionit të saj” janë bërë ndryshime te RM1 dhe RM3.
- Te moduli “Rekrutimi i stafit dhe menaxhimi i burimeve njerëzore” ndryshon titulli dhe shtë hequr RM2.
- Te moduli “Ndërtimi i network-ut social-shëndetësor dhe pjesëmarrja në shoqërinë civile”, janë bërë ndryshime te RM1, RM2 dhe RM3 dhe është shtuar i ri RM4.
- Moduli “Zhvillimi i marketingut në biznesin social-shëndetësor” është hequr dhe është zëvendësuar me modulën e ri: “Shërbime sociale, argëtuese dhe edukative”.

**10. Te skeletkurrikuli i drejtimit “Veterinari”, Niv. IV i KSHK (bllok 4 vjeçar) (zbatohet vetëm klasa 10).**

Te kompetencat profesionale:

- Janë rishikuar dhe plotësuar kompetencat profesionale në përputhje me përshkrimin rishikuar të kualifikimit përkatës.

Te lëndët profesionale:

- Lënda “Zoohigjenë” nuk do të trajtohet.
- Lënda “Higjiena e mjedisit dhe e kafshëve” është lëndë e re dhe ka njohuri nga zoohigjiena dhe njohuri nga higjiena në fermë dhe e mjedisit, si dhe marrëdhënia reciproke kafshë-mjedis.
- Lënda “Mbarështimi i kafshëve bujqësore” është përditësuar dhe pakësohet ngarkesa mësimore në kl. 11 nga 2 orë/javë bëhet 1 orë/javë.
- Lënda “Mikrobiologjia veterinare” ka pësuar rishikim të thellë përmbajtësor duke shtuar edhe njohuri nga profilaksia veterinare, kampionimi dhe analizat laboratorike. Ngarkesa mësimore në kl. 11 rritet nga 1 orë/javë dhe bëhet 2 orë/javë.
- Lënda “Kirurgji veterinare” ka pësuar ndryshime të thella përmbajtësore, duke shtuar edhe njohuri nga profilaksia dhe procedura të thjeshta kirurgjikale.

Te modulet profesionale:

- Moduli i detyruar i praktikës profesionale “Mjelja e kafshëve“ kl.10 nuk do të trajtohet.
- Moduli i detyruar i praktikës profesionale ‘Higjiena e prodhimeve blegtorale” kl.10 është modul i ri me 36 orë mësimore.
- Moduli i detyruar i praktikës profesionale “Mjekimi i plagëve të ndryshme te kafshët“ kl.11 ka pësuar ndryshime përmbajtësore duke shtuar edhe profilaksinë.
- Moduli i detyruar i praktikës profesionale “Përgatitja e strisheve” në kl.11 nuk do të trajtohet.
- Moduli i detyruar i praktikës profesionale “Marrja e mostrave për analiza laboratorike dhe përgatitja e strisheve” kl. 11 është modul i ri me 36 orë mësimore. Ky modul përmban edhe përgatitjen e strishave.
- Moduli i detyruar i praktikës profesionale “Përgatitja e formave të ndryshme farmaceutike”, ka pësuar ndryshime përmbajtësore dhe është ulur ngarkesa mësimore nga 72 orë, në 36 orë.

**11. Te skeletkurrikuli i profilit “Shërbime motori”, Niv. III i KSHK (1 vjeçar), në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”.**

Te kompetencat profesionale:



- Ka ndryshime, janë përshtatur në përputhje me kërkesat e standardit të kualifikimit përkatës.

Te lëndët profesionale:

- Lënda “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12 është rishikuar
- Lënda “Shërbime në motorët e mjeteve të transportit” është rishikuar, janë pakësuar orët (nga 170 orë në 136 orë) si dhe ka ndryshuar shpërndarja e orëve.
- Eshtë shtuar lënda e re “Motorët me komandim elektronik”, me 34 orë

Te modulet profesionale:

- Moduli “Shërbimi i sistemit të ushqimit dhe shkarkimit të motorit” është ndarë në dy module të reja, të veçanta: “Shërbimi i sistemit të ushqimit të motorit” (84 orë) dhe “Shërbimi i sistemit të shkarkimit të motorit” (51 orë)
- Te moduli “Shërbimi i sistemit të ushqimit të motorit” është shtuar edhe një RM për punime në sistemin e ushqimit të motorit me gaz.

**12. Te skeletkurrikuli i profilit “Shërbime xhenerike”, Niv. III i KSHK (1 vjeçar), në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”.**

Te kompetencat profesionale:

- Ka ndryshime, janë përshtatur në përputhje me kërkesat e standardit të kualifikimit përkatës.

Te lëndët profesionale:

- Lënda “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 është rishikuar
- Lënda “Shërbime xhenerike në mjetet e transportit” është rishikuar, kanë ndryshuar synimet, tematika dhe kohëzgjatjet e temave.

Te modulet profesionale:

- Moduli “Shërbimi i sistemit të frenimit të mjeteve të transportit” ka ndryshuar, është shtuar një RM për shërbimet në sistemin e frenimit ABS.
- Te modulet me zgjedhje është shtuar moduli i ri “Shërbimi i sistemit të varjes me komandim elektronik”
- Te modulet me zgjedhje është hequr moduli “Shërbimi i sistemit të frenimit ABS”

**13. Te skeletkurrikuli i profilit “Shërbime elektro-auto”, Niv. III i KSHK (1 vjeçar), në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”.**

Te kompetencat profesionale:

- Ka ndryshime, janë përshtatur në përputhje me kërkesat e standardit të kualifikimit përkatës.

Te lëndët profesionale:

- Lënda “Bazat e sipërmarrjes” është rishikuar
- Lënda “Sistemet elektrike, elektronike dhe kompjuterike në mjetet e transportit” është rishikuar, kanë ndryshuar synimet, përmbajtja si dhe shpërndarja e orëve.
- Lënda “Shërbimet elektrike, elektronike dhe kompjuterike në mjetet e transportit” është rishikuar, kanë ndryshuar synimet, përmbajtja si dhe shpërndarja e orëve.

Te modulet profesionale:

- Eshtë shtuar moduli i ri i detyruar “Shërbime në automjetet hibride dhe elektrike” (51 orë)
- Eshtë shtuar moduli i ri me zgjedhje “Shërbime në pajisjet ndihmëse me komandim elektronik” (51 orë)

- Moduli me zgjedhje “Siguria në punën me autojetet hibride dhe elektrike” është hequr pasi ky aspekt trajtohet në modulën e ri “Shërbime në automjetet hibride dhe elektrike”.
- Moduli “Shërbimi i sistemit kompjuterik të mjetit të transportit” ka pakësim të orëve (nga 66 orë në 33 orë).
- Moduli “Shërbimi i sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimit” ka pakësim të orëve (nga 66 orë në 51 orë).
- Moduli “Shërbimi i elementeve elektrike të pajisjeve ndihmëse” ka pakësim të orëve (nga 69 orë në 66 orë).

#### **14. Te skeletkurrikuli i drejtimit “Bujqësi”, Niv. II i KSHK (2 vjeçar) (zbatohet vetëm klasa 10).**

##### Te kompetencat profesionale:

- Janë plotësuar kompetencat profesionale me aftësi që kanë të bëjnë me përdorimin e burimeve të informacionit dhe platformava dixhitale në funksion të veprimtarive bujqësore, komunikimin me etikë dhe profesionalizëm, si dhe me zbatimin e rregullave të sigurisë në punë, të mbrojtjes së mjedisit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm, në përputhje me standardin e rishikuar të kualifikimit.

##### Te lëndët profesionale:

- Lënda “Bazat e bujqësisë”, kl.10 me 3 orë/javë, ka riformuluar synimet e lëndës, ka pësuar ndryshime përbajtëso duke u shtuar edhe agroteknologjia e kulturave bujqësore. Ndërsa në kl.11, me 1 orë/javë, ka pësuar ndryshime përbajtëso, duke shtuar tema të reja që kanë të bëjnë me praktikën e mira bujqësore, përdorimin e TIK në bujqësi, mënyrat e vjeljes dhe proceset e pasvjeljes së kulturave bujqësore.
- Lëndët “Mbarështim kafshësh bujqësore” kl.10 dhe 11, “Zoohigjienë” kl.11, “Perime dhe lule” kl.10, “Bimët e arave” kl.10, “Pemët frutore” kl.11 dhe “Makinat bujqësore” kl.11, hiqen nga plani mësimor dhe nuk do të trajtohen.
- Lënda “Bazat e blegtorisë” kl.10 dhe 11, është lëndë e re, ku janë integruar përbajtje mësimore që kanë të bëjnë me mbarështimin e kafshëve, higjienën e kafshëve, të ushqyerit, përdorimin e TIK në blegtori, njohuri të thjeshta kirurgjikale.
- Lënda “Kulturat bujqësore”, kl.10, me 5 orë/javë dhe kl.11, me 2 orë/javë, është lëndë e re. Në këtë lëndë janë integruar përbajtje mësimore për të gjitha kulturat bujqësore si perime, bimë arash, pemë frutore, bimë aromatike dhe mjekësore, bimë dekorative dhe lule, kulturat foragjere etj.
- Lënda “Hyrje në teknologjinë bujqësore”, kl.11 me 2 orë/javë është lëndë e re.

##### Te modulet profesionale:

- Moduli “Marrja e mostrës së tokës për analizë” kl.10 me 36 orë mësimore, ka pësuar përmirësime përbajtëso.
- Moduli “Përgatitja e shtretërve për mbjelljen e farave të imëta” kl.10 me 54 orë mësimore bashkohet me Modulën “Prodhimi i fidanëve të kulturave perimore” kl. 10 me 54 orë mësimore. Në këtë modul është shtuar edhe shartimi i kulturave perimore.
- Moduli “Kultivimi i bimëve të arave” kl.10 me 54 orë mësimore, është i ri.
- Moduli “Të ushqyerit në blegtori” është modul i ri dhe zhvillohet në kl.10 me 36 orë.
- Moduli “Përdorimi i veglave të dorës në bujqësi” kl.11 me 69 orë mësimore hiqet nga plani mësimor dhe nuk do të trajtohet.
- Moduli “Prodhimi i fidanëve të kulturave drufrutore” kl.11 me 102 orë mësimore, është modul i ri.

- Modulet “Mirëmbajtja e makinave bujqësore” kl.11 me 51 orë mësimore, si dhe “Përpunimi i thjeshtë i prodhimit foragjer” kl.11 me 51 orë mësimore, janë rishikuar dhe kanë pakësim të orëve mësimore.
- Moduli “Mjelja e kafshëve bujqësore” bëhet modul i detyruar në kl.11 dhe ka pakësim orësh, nga 68 orë, në 51 orë mësimore.
- Moduli “Kujdesi për kafshët bujqësore” kl.11 bëhet me 85 orë mësimore dhe ka pësuar përmirësime përmbajtësore.
- Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar ”Rritja e krimbit të mëndafshit dhe e kërmillit”, “Përpunimi i mbetjeve organike” dhe “Kultivimi i bimëve aromatike dhe mjekësore”, në kl.10 me nga 36 orë mësimore secili, janë module të reja.
- Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar “Mbarështimi i lepujve ”, “Mbarështimi i shpendëve shtëpiakë“ kl.11 me nga 34 orë mësimore secili, janë module të reja.
- Moduli i e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar “Mbjellja e fidanit të hardhisë ”, ka pakësim orësh, nga 68 orë, në 34 orë.
- Moduli i e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar “Shtimi me copa i kulturave bujqësore”, ka ndryshim të titullit, rishikim të përmbajtjes dhe pakësim orësh (bazuar te moduli i mëparshëm “Shtimi me copa i drufrutorëve”).

**ANEKSI 3**

**Formati i rekomanduar i “Planit të mësimdhënies së lëndëve teorike profesionale”**

**Shkolla Profesionale ..... – Tiranë**

**Viti shkollor 2022-2023**

**Drejtimi/Profili profesional ....., Niveli II i KSHK**

**Mësuesi: .....**

**Plani i mësimdhënies së Lëndës Profesionale: ..... (Kodi.....)**

**Klasa 10 – 72 orë mësimore**

<b>Nr</b>	<b>Temat/Kohëzgjatja</b>	<b>Çështjet</b>	<b>Koha</b>	<b>Objektivat mësimore</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>	<b>Vendi/ platforma</b>	<b>Kërkesa për realizimin</b>
<b>1</b>	.....	1.					
		2					
		3					
<b>2</b>		1					
		2					
		3					
		4					
<b>3</b>							
<b>4</b>							
<b>5</b>							

**Koeficientët e ponderimit:      K1 = .....      K2 = .....**

## ANEKSI 4

### Formati i rekomanduar i “Planit të mësimdhënies së moduleve praktike profesionale”

Shkolla Profesionale ..... – Tiranë

Viti shkollor 2022-2023

Drejtimi/Profili profesional ....., Niveli III i KSHK

Mësuesi: .....

Plani i mësimdhënies së Modulit Profesional: ..... (Kodi.....)

Klasa 10 – 36 orë mësimore

Nr	Rezultatet mësimore/Koha	Veprimtaritë mësimore	Koha	Instrumentet e vlerësimit	Vendi	Kërkesa për realizimin
1		-				
		-				
		-				
2						
3						
4						
5						

**ANEKSI 5:**

**Formati i rekomanduar i “Programit të Praktikës Profesionale në Biznes”**

**Shkolla Profesionale ....., Tiranë**

**Drejtimi/profili mësimor: ....., Niv. IV i KSHK**

**Klasa.....**

**Biznesi: .....**

**Mësuesi i praktikës .....**

**Instruktori i biznesit .....**

**Viti shkollor 2022-23**

<b>Nr.</b>	<b>Vendi i punës</b>	<b>Veprimtaritë</b>	<b>Kompetencat profesionale</b>	<b>Koha (ditë/orë)</b>
1				
2				
3				
4				
5				
<b>TOTALI</b>				<b>X ditë/orë</b>